



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3301/8 Prot.

Vlorë më, 18.12.2025

VENDIM

Nr. 98, datë 18.12.2025

**PËR RITJEN E NIVELIT TË PAGAVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE**

Në mbështetje të nenit 49, pika 1, gërma ë, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, pika 1, gërma ë të Statutit të UV-së Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKM-së nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", i ndryshuar; VKM nr. 748, datë 11.6.2009, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", i ndryshuar me VKM Nr. 243, datë 20.04.2023, Udhëzimit të Përbashkët të MAS dhe MFE nr. 20, datë 20.09.2019, "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", referuar shkresës së Administratorit të UV-së me nr. 3146/1, prot, datë 12.12.2025, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 18.12.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojmë rritjen e pagave të personelit akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në masën 3 %, sipas Lidhjes nr. 1 "Strukturat dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" të VKM-së Nr. 243, datë 20.04.2023, "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 748, datë 11.06.2009, *Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë*".
2. Burimi i financimit, të përballohet nga të ardhurat e realizuara nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, prej pagesave të tarifave studentore.
3. Bashkëlidhur relacioni i zëvendësrektorit akademik dhe efekti financiar për vitin akademik 2024-2025.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

